

## SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Menaxhimi i Destinacioneve Turistike</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi - ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Dr. Alberta Tahiri</b>
<b>Detajat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:alberta.tahiri@ushaf.net">alberta.tahiri@ushaf.net</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	
	Lënda “Menaxhimi i Destinacioneve Turistike” paraqet një qasje drejtë informimit të studentëve dhe pasurimit të tyre me njohuritë e nevojshme lidhur me rëndësinë e menaxhimit të duhur të destinacioneve turistike, si element thelbësor ky i cili ndikon në tërheqjen e një numri sa më të madh të turistëve dhe vizitorëve. Qasja në literaturën e përzgjedhur nga autorë të huaj dhe vendor, si dhe hulumtimet për destinacionet turistike vendore ofrojnë një përmbledhje të begatshme për studentët të cilët ndjekin leksionet nga kjo lëndë.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	Qëllimet kryesore të kësaj lënde ndërlidhen me rëndësinë e menaxhimit efikas të destinacioneve turistike, përkatësisht me aftësimin e studentëve në këtë fushë dhe me informimin e tyre për të gjitha destinacionet turistike të Kosovës të cilat ndikojnë në zhvillimin e turizmit si sektor i ekonomisë, dhe në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit. Pra, synohet të arrihet njohja e destinacioneve turistike, rëndësia e zhvillimit dhe mbrojtjes së tyre, roli i zhvillimit të tyre në veçanti në turizëm dhe në përgjithësi në ekonominë shtetërore.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	Në përfundim të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të kuptojnë konceptet që iu paraqiten lidhur me destinacionet turistike dhe menaxhimin e tyre;</li> <li>▪ Të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit efikas të destinacioneve turistike në tërheqjen e turistëve dhe vizitorëve;</li> <li>▪ Të shpjegojnë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të destinacioneve turistike;</li> <li>▪ Të njohin destinacionet dhe atraksionet turistike në vendin tonë;</li> <li>▪ Të krahasojnë zhvillimet e destinacioneve të ndryshme turistike dhe të paraqesin vështimet e tyre kritike për problematika të caktuara.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	1	2
Ushtrime në teren	2	2	4
Kollokfiime, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj.	3	1	3
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste të studimit dhe diskutime në klasë, punime seminarike, diskutime, punë në grupe, etj.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kolokviumi i parë: 0-30% Kolokviumi i dytë: 0-30% Ushtrimet, seminarët: 0-20% Hulumtimet shkencore: 0-10% Interaktiviteti: 0-10% Provimi përfundimtar: 100%  Provimi final është vlerësuar me 100% të notës. Provimi përbëhet prej pyetjeve me përgjigje të mundshme, pyetjeve të hapura, dhe një rast të studimit.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	John Swarbrooke, "The Development and Management of Visitor Attractions", Second edition, Butterworth-Heinemann, Great Britain, 2002.		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Armand Krasniqi &amp; Fatos Ukaj, Administrimi publik i agjencive dhe destinacioneve të turizmit në Kosovë, (Monografi), 2017.</li> <li>▪ Julia N. Albrecht, "Visitor Management in Tourism Destinations", CABI, 2017.</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nazmi Kozak &amp; Metin Kozak, "Tourist Destination Management: Instruments, Products, and Case Studies", Springer, 2019.</li> <li>▪ Youcheng Wang &amp; Abraham Pizam, "Destination Marketing and Management: Theories and Applications", CAB International, 2011.</li> </ul>
--	---

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Prezentimi i syllabusit dhe hyrje e përgjithshme për lëndën
<b>Java e dytë:</b>	Roli i tërheqjes së vizitorëve në turizëm Produkti i tërheqjes së vizitorëve
<b>Java e tretë:</b>	Tregu i tërheqjes së vizitorëve Mjedisi i biznesit dhe tërheqja e vizitorëve
<b>Java e katërt:</b>	Procesi i zhvillimit dhe roli i studimeve të fizibilitetit Faktorët që ndikojnë në suksesin e tërheqjes së vizitorëve
<b>Java e pestë:</b>	Financimi i projekteve për tërheqjen e vizitorëve Projektimi i atraksioneve për vizitorët
<b>Java e gjashtë:</b>	Menaxhimi i projektit
<b>Java e shtatë:</b>	Kolokviumi I
<b>Java e tetë:</b>	Roli i menaxherit dhe stilet e menaxhimit
<b>Java e nëntë:</b>	Koncepti i marketingut Planifikimi strategjik i marketingut Zbatimi i strategjive të marketingut
<b>Java e dhjetë:</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Menaxhimi financiar
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Menaxhim operacionesh
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Sfidat etike në menaxhimin e atraksioneve Menaxhimi i cilësisë
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Menaxhimi i ndryshimit dhe planifikimi për të ardhmen
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Kolokviumi II

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.